




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS PUBLIKE
SEKTORI I PROJEKTEVE PUBLIKE



RELACION TEKNIK

OBJEKTI:

"Ndërtim godine për zyra të MZSH"

PËRSHKRIMI I GJËNDJES EKZISTUESE

1. Të përgjithshme

Ky projekt parashikon ndërtimin e një godine të re njëkatëshe me sipërfaqe ndërtimi 220 m², e destinuar për nevojat administrative dhe operative të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të Bashkisë Durrës. Objekti pozicionohet në pjesën e pasme të godinës ekzistuese të MZSH-së, brenda territorit funksional të stacionit ekzistues.

2. Vendndodhja

Godina e re integrohet me kompleksin ekzistues të MZSH-së duke respektuar organizimin urban dhe funksional të tij. Vendosja e objektit nuk cenon qarkullimin e automjeteve zjarrfikëse, manovrimin e mjeteve të emergjencës apo aksesin në ambientet ekzistuese.



Foto të gjendjes ekzistuese



Koncepti arkitektonik

Objekti është konceptuar si një volum i thjeshtë njëkatësh me karakter institucional dhe arkitekturë funksionale. Zgjidhja synon efikasitetin e përdorimit, fleksibilitetin e ambienteve dhe minimizimin e kostove të mirëmbajtjes.

Organizimi funksional

Godina organizohet në ambiente zyrash, hapësira pune dhe ambiente ndihmëse për personelin e MZSH-së. Organizimi i brendshëm garanton komunikim të shpejtë ndërmjet ambienteve, ndriçim natyral dhe ventilim të mjaftueshëm.

Zgjidhja konstruktive

Objekti realizohet me strukturë betonarme dhe elementë metalikë sipas projektit konstruktiv. Mbulesa realizohet me panele sanduiç të termoizoluara të mbështetura mbi trarë metalikë IPE 200.

Materialët dhe përfundimet

Në mbulesë parashikohet izolim me lesh xhami dhe tavan i varur me gips. Dyshemetë realizohen me pllaka qeramike mbi soletë betoni dhe shtresa mbushëse me çakëll. Fasadat trajtohen me materiale rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe mjedisit detar të qytetit të Durrësit.

Infrastrukturat

Objekti do të lidhet me rrjetet ekzistuese të ujësjellësit, kanalizimeve, energjisë elektrike dhe telekomunikacionit të godinës ekzistuese të MZSH-së.

Siguria dhe aksesueshmëria

Projekti është hartuar në përputhje me kërkesat për sigurinë në përdorim, evakuimin në raste emergjence dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara.

Përfundime

Ndërtimi i godinës së re prej 220 m² do të përmirësojë ndjeshëm kushtet e punës së personelit të MZSH-së dhe do të rrisë kapacitetet administrative dhe operative të shërbimit të emergjencës në Bashkinë Durrës.

The floor plan shows a rectangular building with a central corridor. The top half contains a living area with a fireplace, a dining area with a table and chairs, and a kitchen with a sink and stove. The bottom half contains four bedrooms, each with a bed and a wardrobe. A bathroom is located between the kitchen and the bedrooms. The plan is annotated with numerous dimensions in millimeters and centimeters, and room numbers 299, 292, and 302. A north arrow is located in the upper right corner.

Drejtor: Alda Zyferi

Punoi: Ing. Eni Turkeshi
Ark. Nevian Mançe
Ing.elek.Mariglen Jahollari